



HOME » AKTUALITET » VRAU VËLLAIN, DETAJE TË REJA NGA NGJARJA E RËNDË NË PEQIN

NJOFTIMI I POLICISË**Vrau vëllain, detaje të reja nga ngjarja e rëndë në Peqin****Vezët më të zgjedhura !****09.03.2019 - 21:51**

Detaje të reja janë zbuluar nga policia në lidhje me ngjarjen e rëndë që tronditi Peqinin mbrëmjen e sotme.

Një 14-vjeçar vrau aksidentalisht me armë gjahu vëllain e tij 21-vjeçar, Roland Sheshi.

Mësohet se i mituri me inicialet K.LI 14 vjeç, ka qëlluar për vdekje, aksidentalisht me armë gjahu të vëllain, 21 vjeçarin Roland Lleshi.





‘Në pyllin e fshatit Galush, Peqin, dyshohet se një i mitur i cili ende nuk ka mbushur moshën 14-vjeç, dyshohet se nga pakujdesia iu shkrep arma e gjahut dhe ka vrarë vëllain e tij shtetasin R.LI., 20 vjeç.

Ata ishin duke kullotur bagëtitë kur ndodhi ngjarja. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes’, thuhet në njoftim.

